



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI

PROGRAMI I TRANSPARENCËS
PËR
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, është përgatitur Programi i Transparencës për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”* (LDI) si dhe në kuadër të VKM nr. 781, dt 26.12.2018 *“Për garantimin e transparencës në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”*.

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (këtej e tutje UMT), ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. UMT-ja do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së UMT-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.umed.edu.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i Transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të Programit të Transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet të UMT-së. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e UMT-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë, i cili duhet të jetë i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm dhe i pajtueshëm me dokumentet origjinale që posedohen nga UMT-ja.

Në rubrikat e faqes zyrtare të internetit të UMT-së, pasqyrohen edhe informacione të cilat karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale, për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve dhe të të dhënave, etj.

Skema e publikimit me rubrikat përkatëse, sipas specifikimeve të bëra në Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar”, paraqitet në tabelën përmbledhëse të evidentuar më poshtë në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME:

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së UMT -së janë:

1. “E drejta për informim”, është njw e drejtë kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. “Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave”, UMT-ja ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. “Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore” që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e UMT-së dhe përkatësisht:
 - Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencorë në institucionet e arsimit të lartë në RSH” dhe të gjitha aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;
 - Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
 - Ligji nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
 - Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” i ndryshuar;
 - Ligji nr. 35, datë 31.02.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”;
 - Ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

Akteve nënligjore (VKM, Udhëzime, etj):

- VKM nr. 112 datë 23.2.2018, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademike “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor” i ndryshuar;
- VKM nr. 777, datë 26.12.2018, “Për kontrollin antiplagjaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar;
- VKM nr. 748, datë 11.6.2009, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr.1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë” i ndryshuar.



Statuti i UMT-së, miratuar Tiranë 2019; Rregullore e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë miratuar nga Senati Akademik me Vendimin nr. 44, dt 26.11.2014, i ndryshuar; Rregullore e Këshillit të Botimeve, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë miratuar më 26.11.2014; Rregullore “Për Fitimin e Titujve Akademike në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” miratuar më 2020; Rregullore e Funksionimit të Njesisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, Tiranë 15 qershor 2015; Rregullore për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në UMT, Kodi i Etikës i UMT, etj.

4. “Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme”.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (këtej e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - i plotë;
 - i saktë;
 - i përditësuar;
 - i thjeshtë në konsultim;
 - i kuptueshëm;
 - lehtësisht i aksesueshëm;
 - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.umed.edu.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të UMT-së;
- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të UMT-së dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të UMT-së, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim



të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të UMT-së, dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi UMT-në, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës të universitetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit;
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", dhe të ligjit nr. 125/2013, "*Për koncesionet dhe partneritetin publik privat*" i ndryshuar, që kryhen për llogari të UMT-së, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e UMT-së, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre, apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të UMT-së, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor institucioni për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- UMT-ja, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje dixhitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga UMT-ja.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË UMT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/ Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse në UMT
Rreth UMT-së: UMT është ent publik i arsimit të lartë i cili ka për funksion dhe qëllim zhvillimin e arsimit të lartë pas përfundimit atij të mesëm, kualifikimin dhe dhënien e gradave shkencore dhe titujve akademikë. Ai përbëhet nga tre fakultete: Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike.	1. Struktura organizative / Organigrama; 2. Struktura e pagave;	Neni 9/ 3 i Statutit të UMT-së. VKM nr. 329 dt 12.4.2017 " <i>Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik</i> ". VKM nr. 748, dt 11.6.2009 " <i>Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në IAL</i> ", i ndryshuar. VKM nr. 187 dt 8.3.2017 " <i>Për miratimin e strukturës</i> " i	www.umed.edu.al	Pas miratimit nga struktura përgjegjëse.	Publikuar në faqen zyrtare www.umed.edu.al Senati Akademik, Bordi i Administrimit; Bordi i Administrimit. Drejtoria Ekonomike.

		ndryshuar VKM nr.717, datë 23.06.2009 " <i>Për pagat e punonjësve mbeshtetës...</i> " i ndryshuar.				
	3. Funksionet dhe detyrat e UMT-së;	Neni 4, 5 dhe 6 i Statutit të UMT-së.				
	4. CV-të dhe pagat e nënpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, përshkrim të procedurës së zgjedhjes, kompetencat dhe detyrat e tyre;	Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003 " <i>Për deklarimin dhe kontrollin....</i> " dhe Ligjin nr 9367, datë 07.04.2005 " <i>Për parandalimin e konfliktit.....</i> " neni 28 dhe neni 54 i Statutit të UMT-së, neni 29 dhe 55 i Statutit të UMT-së.				
	5. Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të UMT-së për të marrë vendime;	Ligji nr. 80/2015 " <i>Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor....</i> ", nenet 28, 29, 54, 55 të Statutit të UMT-së, Kodi i Procedurave				

Rektori,
Administratori i
UMT-së.



	6. Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e UMT-së (përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin kërkesave dhe ankesave – afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve).	Administrative i RSH. Ligji nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 7/1/c/g.	Kërkesat për informim bëhen sipas formatit tip që gjendet në www.umed.edu.al dhe drejtohen në adresën postare: Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Rruga e Dibrës, Nr.371, 1005 ose në adresën zyrtare të e-mailit: info@umed.edu.al .	Brenda 48 orëve nga miratimi i Programit të Transparencës.		Spektori i Koordinimit Institucional, Spektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik dhe Komunikimit, Specialist IT (Web).
Kuadri ligjor rregullator (tekstet e plotë)	1. Legjislacion ndërkombëtar; 2. Legjislacion kombëtar; 3. Aktet nënligjore; 4. Rregullore; 5. Kodi i sjelljes; 6. Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave apo lirive themelore të	Ligji nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 7/1/b.	www.umed.edu.al	Brenda 48 orëve nga ardhja në formë zyrtare e një akti ligjor ose nënligjor në fushën e arsimit të lartë.	Publikuar në faqen zyrtare të www.umed.edu.al	Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Spektori i Shërbimeve Juridike. Spektori i Kërkimit Shkencor dhe



	individit; 7. Strategji; 8. Raport vjetor; 9. Manuale/ dokument politikash që ka lidhje m funksionet e UMT-së dhe që prek publikun.					Promovimit Akademik dhe Komunikimit, Specialist IT (Web).
E drejta për tu informuar dhe për tu ankuar	1. Koordinator/ emri, mbiemri; 2. E.mail; 3. Adresa; 4. Orari; 5. Format kërkesë/ shpjeguese (hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për	Ligji nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 7/1/ç, neni 10. Ligji nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 3 dhe 11.	Koordinator: Dhurata Islambejo; Dhurata.islambejo@umed.edu.al Adresa: Rruga e Dibrës, Nr.371, 1005, Tiranë. Orari zyrtar E hënë - e enjte 08:00 - 16:30. E premte 08:00 - 14:00. Format i kërkesës për informacion mund të aksesohet në faqen zyrtare të UMT-së, rubrika Programi i	Pas miratimit të Programit të Transparencës. Menjëherë në rast ndryshimesh.	Publikuar në faqen zyrtare të www.umed.edu.al	Sektori i Koordinimit Institucional. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës.



	informim);		Transparencës.			
	6. Format ankese / shpjeguese (procedura e ankimit tek Komisioneri).	Ligji nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 24.				
Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi UMT	1. Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë; 2. Planet strategjike të punës; 3. Raporte monitorimi / auditimi (p.sh KLSH); 4. Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës së UMT-së.	Ligji nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 7/1/dh; Ligji nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor...”, neni 32, 116; Ligj nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Ligji nr 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar	www.umed.edu.al Plan strategjik i UMT-së 2017-2020; Raporte auditimi të kryera në njësitë vartëse. Regjistri i riskut UMT-ë. Raporti vjetor mbi cilësinë e kontrollit të brendshëm.	Brenda 48 orëve nga miratimi i Programit të Transparencës dhe në vijim të raporteve përfundimtare.	Publikuar në faqen zyrtare të www.umed.edu.al	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës. Njësia e Auditimit të Brendshëm. GMS e UMT-së Kordinatori i MFK-ve.

		<i>dhe kontrollin” i ndryshuar.</i>				
Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të UMT-së	1. Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara; 2. Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset; 3. Donacione, sponsorizime; 4. Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e liçensuara.	Ligji nr 119/2014 “<i>Për të drejtën e informimit</i>” neni 7/1/e. Ligji nr.80/2015 “<i>Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor...</i>” neni 38/h, neni 49/c; Ligji nr 10 296, datë 08.07.2010 “<i>Për menaxhimin financiar dhe kontrollin</i>” i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2088 “<i>Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH</i>” i ndryshuar.	www.umed.edu.al Plani buxhetor aftmesëm.	Nga hyrja në fuqi e akteve ligjore dhe nënligjore. Menjëherë pas miratimit nga Bordi i Administrimit i UMT-së.	Publikuar në faqen zyrtare të www.umed.edu.al	Administratori i UMT-së; Drejtoria Ekonomike.
Informacion për procedurat e prokurimit/ procedurat konkurruese të koncesionit/ partneritetit publik	1. Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve);	Ligji nr 119/2014 “<i>Për të drejtën e informimit</i>” neni 7/1/ë; Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “<i>Për prokurimin publik</i>”.	Regjistri i prokurimeve; Regjistri i realizimit të kontratave	Brenda 48 orëve nga hyrja në fuqi ose ardhja në formë zyrtare e një akti ligjor ose nënligjor në fushën e prokurimit.	Publikuar në faqen zyrtare të www.umed.edu.al dhe në www.app.gov.al	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Sektori i Prokurimeve.

privat	2. Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik; 3. Regjistri i realizimeve të prokurimit publik;					
Shërbimet që ofrohen nga UMT	Lista e shërbimeve që ofron UMT përfshirë: ➤ Tarifatat përkatëse ➤ Formular aplikimi ➤ Afati kohor ➤ Procedurë ankimimi ➤ Standartet për cilësinë e shërbimit.	Ligji nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 7/1/f; Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor...” nenet 69-82 (organizimi i studimeve në IAL), nenet 59 – 61 (fitimi i titujve dhe gradave), neni 11/1/b (ofrimi i bursave të studimit për studentët e shkëlqyer), neni 85/1 (e drejta e ndjekjes së një programi të dytë studimi), neni 93- 96 (veprimtaria kërkimore-shkencore); Neni 4 i Statutit të	Formularët e aplikimit dhe dokumentacioni shoqërues	Përditësohet periodikisht	Publikuar në faqen zyrtare të www.umed.edu.al	Sektori i Koordinimit Institucional; Drejtoria e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit; Drejtoria Ekonomike; Fakultetet nëpërmjet degës së financës.

		UMT-së.				
Procedurat/ mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/ nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të UMT- së	1. Njoftimi dhe konsultimi publik 2. Komete/ Rekomandime/ Opinione të palëve të interesuara/ grupe interesi; 3. Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve; 4. Raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes; 5. Procedura/ mekanizma për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të UMT-së; 6. Emër, mbiemër të koordinatorit për konsultimin publik, adresë postare/	Ligji nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 7/1/gj; Ligji nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.	www.umed.edu.al	Në një kohë sa më të shpejtë nga miratimi i Programit të Transparencës.	Publikuar në faqen zyrtare të www.umed.edu.al	Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore; Drejtoritë përkatëse sipas natyrës së p/aktit.



	elektronike.					
Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve	1. Lista e dokumenteve që administrohen nga UMT, me afatet e ruajtjes; 2. Formën e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje, fizike, audio, video, foto).	Ligji nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 7/1/h; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Vendimi nr. 4, datë 19.06.2017 “Rregullore e Njësuar e Punës me dokumentet në Autoritetet Publike të Republikës së Shqipërisë”; Si dhe normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSh.	Arshiva dhe librat e protokollit. (Tabelë përmbledhëse mbi afatet e ruajtjes së dokumentacionit)	Me kërkesë të individualizuar	Publikuar në faqen zyrtare të www.umed.edu.al	Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës.
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar (modeli i regjistrin i miratuar nga Komisioneri).	Ligji nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 7/1/i, neni 8.	Kërkesat për informim bëhen sipas formatit tip. Pasqyrohen në regjistrin e kërkesave për informim.	Brenda 48 orëve nga miratimi i Programit të Transparencës	Publikuar në faqen zyrtare të www.umed.edu.al	Sektori i Kordinimi Institucional.
Informacione/	1. Njoftime të	Ligji nr 119/2014 “Për	Njoftimet në APP	Me kërkesë brenda	Me kërkesë	Sektori i



dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikun nga UMT-ja.	ndryshme; 2. Njoftime për procedurat e rekrutimit/ pranimi në UMT; 3. Raporte; 4. Publikime; 5. Statistika; 6. Projekte; 7. Bashkëpunime etj.	<i>të drejtën e informimit</i>” neni 7/1/k/l; Kodi i Proçedurave Administrative i RSH.	për shpalljen e pozicioneve vakante në UMT; Listat e kandidatëve fitues në një nga ciklet e studimit të ofruara nga UMT-ja; Të dhëna për projektet në të cilat UMT-ja është angazhuar; Studentët e ekselencës dhe studentët e shkëlqyer të UMT-së; Studenët që përjashtohen/përgjysmohet tarifa e shkollimit.	10 ditë pune, pas miratimit nga titullari i institucionit.	Publikuar në faqen zyrtare të www.umed.edu.al	Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës; Drejtoria e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës; Drejtoria Ekonomike.
--	--	--	--	--	--	--






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, UMT-ja vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.umed.edu.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.

LIDHJA NR. 2


REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Statusi i kërkesës (5)	Tarifa (6)
1					
2					

Shënim:

Rregjistri përditësohet çdo tre muaj.

1. Evidentohet kronologjia e kërkesave.
2. Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.
3. Identifikohet lloji i kërkesës.
4. Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes. *(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale")*.
5. Ndhmon kërkuuesin për të njohur ecurinë e procesit.
6. Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.



LIDHJA NR. 3 (kërkesa)**KËRKESE PËR INFORMACION**

Emër Mbiemër: Z./Znj. _____	Adresa postare: _____ Adresa elektronike: _____ Nr. Tel: _____	Data: ___/___/202__ Nënshkrimi: _____
--	--	--

(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Të tjera të dhëna


Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni: _____ _____ _____
--

Vetëm për përdorim zyrtar		
Data e marrjes: ___/___/201__	Numri rendor i kërkesës:	Komente: _____ _____ _____



Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



LIDHJA NR. 3 (përgjigja)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
(AUTORITETI PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____/202__

Lënda: Jepet informacioni/dokumentacioni i kërkuar.

Kërkuesit: Z/Znj. _____

Adresa:

Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë (autoriteti publik), në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor ___, datë __/__/201__ (sipas rregjistrimit përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve).

Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni (përshkrim i akteve/informacioneve /dokumentacionit që kërkohet).

1. _____
2. _____
3. _____

AUTORITETI PUBLIK

Shënim:

Standardi kërkon domosdoshmërisht adresën zyrtare dhe elektronike si dhe kontaktet e autoritetit publik.

LIDHJA NR. 4/a



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
(AUTORITETI PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____/202__

Lënda: Mbi refuzimin e formës së kërkuar të informacionit / dokumentacionit.

Kërkuesit: Z/Znj. _____

Adresa:

Në zbatim të pikës 4 të nenit 14 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, për arsye se (arsyetohet pse autoriteti nuk disponon..(p.sh) të tilla mjete/ aparate/ pajisje që bëjnë të mundur dhënien e dokumentacionit në formatin e kërkuar), ju refuzohet dhënia e tij në formën e kërkuar.

Ndaj refuzimit të kërkesës tuaj, mund të ankoheni pranë Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me nenin 24/1,2/a të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

AUTORITETI PUBLIK

Shënim:

Standardi kërkon domosdoshmërisht adresën zyrtare dhe elektronike si dhe kontaktet e autoritetit publik.

LIDHJA NR. 4/b



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
(AUTORITETI PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____/202__

Lënda: Mbi zgjatjen e afatit të kthimit të përgjigjes.

Kërkuesit: Z/Znj. _____

Adresa:

Në zbatim të pikës 3 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, për arsye se (evidentoni në përputhje me parashikimet në gërmat “a”, “b”, “c” të nenit 15/3), vendoset për zgjatjen e afatit të kthimit të përgjigjes me 5 ditë pune.

Ndaj mosnjoftimit të zgjatjes së afatit të shqyrtimit, mund të ankoheni pranë Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me nenin 24/1/2/a të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

AUTORITETI PUBLIK

Shënim:

Ky akt zyrtar i njoftohet menjëherë kërkuesit.

Standardi kërkon domosdoshmërisht adresën zyrtare dhe elektronike si dhe kontaktet e autoritetit publik.

LIDHJA NR. 4/c



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
(AUTORITETI PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____/202__

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurës për rishikim të dokumentacionit të klasifikuar dhe shtyrje të afatit.

Kërkuesit: Z/Znj. _____

Adresa:

Në zbatim të pikës 5 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ju njoftojmë se ka nisur procedura për rishikimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, në përputhje me ligjin nr. 8457, datë 11/02/1999 “Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, i ndryshuar.

Në këtë rast, afati për vlerësimin e dhënies së informacionit shtyhet (deri në 30 ditë pune).

AUTORITETI PUBLIK

Shënim:

Standardi kërkon domosdoshmërisht adresën zyrtare dhe elektronike si dhe kontaktet e autoritetit publik.